



RAPORT I PJESSHËM

MONITORIMI I PROCESIT TË NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (KZAZ)

Gjatë muajit Maj 2019, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) realizoi monitorimin e procesit të ngritjes dhe funksionimit të 28 Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve) në 8 qytete të vendit. U monitoruan përkatësisht: 7 KZAZ në qytetin e Tiranës, 4 KZAZ në qytetin e Vlorës, 3 KZAZ në qytetin e Durrësit, 3 KZAZ në qytetin e Fierit, 4 KZAZ në qytetin e Shkodrës, 2 KZAZ në qytetin e Korçës, 1 KZAZ në qytetin e Gjirokastrës dhe 4 KZAZ në qytetin e Elbasanit.

Në aspektin metodologjik, grumbullimi i të dhënave cilësore dhe statistikore u realizua mbi bazën e pyetësorit të përgatitur nga KShH, në formën e bashkëbisedimit me kryetarët, sekretarët ose zv/kryetarët, si dhe monitorimit periodik të veprimtarisë së KQZ-së. Në shumicën e KZAZ-ve objekt monitorimi, ky proces u realizua gjatë pjesës së dytë të ditës, për shkak se personi i autorizuar ose përgjegjës për dhënien e informacionit e ushtronte funksionin me kohë të pjesshme.

Gjatë monitorimeve të realizuara, në pjesën më të madhe të KZAZ-ve vëzhguesve të KShH-së nuk i është kufizuar aksesit. Ndërkohë që vëzhguesit nuk patën akses të plotë në KZAZ nr. 2, si dhe patën akses të pjesshëm në KZAZ nr. 3, 4 dhe 5 në qytetin e Shkodrës.

KShH konstatoi se afati 18.03.2019 për paraqitjen e propozimeve për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve nuk u respektua nga ana e forcave të opozitës parlamentare. Subjekti Zgjedhor (Partia Socialiste) në përputhje me afatin e parashikuar në nenin 28, pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur 360 kandidatë për anëtarë dhe sekretarë të të gjitha KZAZ-ve në rang vendi. KQZ ushtroi kompetencën e parashikuar në nenin 29, pika 5 e Kodit, duke emëruar kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimarrje. KShH vëren se bojkoti nga ana e partive politike të opozitës parlamentare ka ndikuar në mosrespektimin e parashikimit ligjor të pikës 2 të nenit 29 të Kodit, i cili parashikon përkatësinë e kundërt të kryetarit nga zv/kryetari. Nga monitorimi i KShH-së këto vende rezultojnë të jenë vakante në KZAZ-të e vëzhguara.

Gjatë monitorimit të faqes zyrtare të KQZ-së, KShH ka konstatuar se nuk rezulton të jenë publikuar vendimet nr. 140, datë 09.04.2019 dhe nr. 141, datë 09.04.2019. Në argumentimin e vendimit nr. 173, datë 16.04.2019 “Për emërimin kryesisht të sekretarëve të disa KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019”, rezulton se në këto mbledhje KQZ ka miratuar kryesisht anëtarin e katërt në KZAZ me numër tek dhe sekretarët në KZAZ-të me numër çift. Nga data 15.01.2019 deri më datë 30.05.2019, KShH ka konstatuar se KQZ ka marrë vendim në 12 raste për të liruar nga detyra dhe emëruar anëtarët/sekretarët e KZAZ-ve.¹

Gjithashtu, KShH ka konstatuar se në faqen zyrtare të KQZ-së nuk është publikuar vendimi nr. 142, datë 09.04.2019. Nga argumentimi i vendimit nr. 184, datë 23.04.2019 “Për emërimin e

¹Vendimet e shqyrtuara janë: nr. 172, dt. 16.04.2019; nr. 173, dt. 16.04.2019; nr. 183, dt. 23.04.2019; nr. 216, dt. 27.04.2019; nr. 250, dt. 07.05.2019; nr. 274, dt. 10.05.2019; nr. 348, dt. 15.05.2019; nr. 606, dt. 21.05.2019; nr. 609, dt. 21.05.2019; nr. 610, dt. 21.05.2019; nr. 640, dt. 23.05.2019; nr. 652, dt. 26.05.2019.

kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019” rezulton se në këtë vendimarrje jo të publikuar nga KQZ është thirrur mbledhja e parë e KZAZ-ve respektive.

KQZ ka bërë zëvendësimin e anëtarëve të dorëhequr ose të anëtarëve të cilët nuk janë paraqitur në tre mbledhje rrjesht të KZAZ-ve, në disa prej tyre në rang vendi (në radhët e subjektit zgjedhor Partia Socialiste). Gjithashtu, ky zëvendësim ka ardhur edhe për shkak të kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti zgjedhor, përfshirja në listën emërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Bashkisë Vlorë etj.

Nga informacioni i vënë në dispozicion të vëzhguesve të KShH-së nga personat e autorizuar me të cilët u mor kontakt u vërejt se në pjesën më të madhe të KZAZ-ve, anëtarët dhe sekretarët plotësojnë kushtet e parashikuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit. Pyetjes lidhur me tematikat e trajnimit ju është dhënë përgjigje e përgjithshme dhe jo e specifikuar nga ana e personave me të cilët u mor kontakt. U konstatua se anëtarët zëvendësues nuk janë trajnuar ende nga ana e KQZ-së dhe nuk ka një planifikim konkret se kur do të realizohet trajnimi i tyre.

Nga komunikimi me rojen e KZAZ-së nr. 2 në Shkodër, i është shprehur (citojmë): “Anëtarët e KZAZ-së janë paraqitur vetëm një ditë në ambientet e pallatit të sportit, kanë marrë një zyrë, i kanë ndërruar bravën dhe nuk janë paraqitur më”. Vëzhguesi i KShH-së konstatoi se KZAZ nr. 82, në qytetin e Vlorës nuk ka vazhduar *de facto* veprimtarinë e saj. Në këtë ambient nuk është konstatuar asnjë element identifikues i KZAZ-së, ndërkohë që sekretarja e kontaktuar u shpreh se akoma nuk i është vënë në dispozicion çelësi i zyrës.

Elementët identifikues, me qëllim garantimin e aksesueshmërisë së zgjedhësve pranë KZAZ-ve nuk rezultuan se janë respektuar në të gjitha KZAZ-të. P.sh.: në qytetin e Tiranës, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se vetëm në KZAZ nr. 34 dhe nr. 36, me vendndodhje pranë Shkollës ‘Bajram Curri’ u vërejt afishimi i këtyre elementëve në 3 pozicione të ndryshme: tek hyrja kryesore, tek dera e KZAZ dhe tek xhamat e shkollës në pjesën e jashtme. KShH nuk vërejt materiale propagandistike të afishuara pranë KZAZ-ve.

Gjatë monitorimeve u konstatua se ambientet e këtyre KZAZ-ve, në brendësi të shkollave nuk ishin të përshtatshme për realizimin e mbledhjeve. KShH rekomandon që KZAZ-të të vendosen në katet e para të ndërtesave me akses të lirë, me qëllim garantimin e aksesueshmërisë edhe për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Në ditën e parë të monitorimit, KZAZ nr. 22 në qytetin e Durrësit ka qenë e vendosur në një ambient provizor të një klase (shkollë), në mungesë të vënies në dispozicion të një ambienti lehtësisht të aksesueshëm. Në vijim të monitorimit, u vërejt zhvendosja në ambientet e palestrës së Shkollës së Mesme Profesionale ‘Hysen Çela’.


U konstatua se shumica e KZAZ-ve të monitoruara kanë në dispozicion materialet e nevojshme të kancelarisë dhe materialet zgjedhore.

Vëzhguesit e KShH-së nuk kanë mundur të verifikojnë gjithë dokumentacioni e KZAZ-ve, për shkak se librat administrohen nga sekretari, i cili ose nuk ka marrë pjesë në bashkëbisedim ose nuk i ka pasur me vete në momentin e realizimit të monitorimit. Në fakt këto dokumente duhet të qëndrojnë në ambientet e brendshme të KZAZ-ve dhe të sigurohen nga ndërhyrjet e jashtme. Vëzhguesit të KShH-së në KZAZ nr. 36, i është komunikuar se deri në datën e realizimit të monitorimit, janë zhvilluar 4 mbledhje. Nga kqyrja e Librit të Protokollit të Mbledhjeve rezulton se është pasqyruar vetëm mbledhja konstituuese, e cila mban datën 12.04.2019. Në KZAZ-të nr. 30 dhe 36 nuk rezulton e dokumentuar asnjë vendimarrje në Regjistrin e Vendimeve. KZAZ-të rezultojnë të konstituara, por ky moment juridik nuk rezulton të jetë pasqyruar me vendimarrje. KShH konstatoi se KZAZ-të në rang vendi i publikojnë vendimarrjet e tyre sipas standardeve të ndryshme. Vëzhguesi i KShH-së vëren se anëtarët e KZAZ-së nr. 24, në qytetin e Durrësit, deklarojnë se kanë mbajtur një mbledhje me qëllim marrjen e bazës materiale dhe vendimin për

propozimin e kryetarit të KZAZ-së. KShH konstaton se kjo mbledhje nuk gjendej e pasqyruar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Ky fakt i konstatuar bie ndesh me detyrimin ligjor të parashikuar në nenet 13, pika 2, gërma ç), 23 pika 5 KZ, si dhe Udhëzimin nr. 2/2009 të KQZ-së.

KShH konstatoi se vendimarrjet në të gjitha KZAZ-të kanë gjetur miratimin unanimit të të gjithë anëtarëve dhe nuk është konstatuar asnjë qëndrim kundër.

U referua si problematikë nga ana e Kryetarit të KZAZ nr. 38 në Tiranë, procesi i ndryshimit të disa qendrave të votimit për shkak se në zgjedhjet e mëparshme është konstatuar se janë vendosur në ambiente larg vendbanimit/vendqëndrimit të zgjedhësve.



This report has been produced with the financial assistance of the Federal Republic of Germany. The implementation of this project is carried out by Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the Federal Republic of Germany.